



Republika e Shqipërisë
Universiteti i Sporteve të Tiranës
Rektorati

Nr. 1131 Prot.

Tiranë, më 15.11, 2016

VENDIM

Nr. 105 datë 15.11 2016

Mbi

përdorimin e palestrave nga studentët e UST, jashtë procesit mësimor.

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 98/1 pika b, për t’i krijuar hapësirat e nevojshme që studentët të përdorin palestrat e UST jashtë orarit mësimor, Rektorati

V E N D O S I:

1. Palestrat e UST të jenë të hapura për tu përdorur nga studentët e UST jashtë orëve mësimore nga e Hëna deri të Premten në orarin 14⁰⁰ deri 15⁰⁰.
2. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Fakulteti i Veprimtarisë Fizike e Rekreacionit të marrin masat që në këtë orar në palestrat të jetë i pranishëm laboranti, i cili do të kujdeset për mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive të studentëve.
3. Në vijim të përvojës së vitit të kaluar studentët që do shfrytëzojnë palestrat të grupohen dhe një përfaqësues i tyre bën kërkesën pranë Dekanit të FSHL për Sallën e Lojrave, dhe Palestrën e gjimnastikës, ndërsa për palestrën e fitnesit pranë dekanit të FVFR. Kërkesa bëhet sipas formularit bashkëngjitur këtij vendimi.
Dekani pasi e trajton këtë kërkesë e përcjell për miratim përfundimtar pranë Rektorit. Më tej, Rektori ngarkon me detyra përkatëse Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve Sportive dhe Shërbimeve.
Studentët për të hyrë në palestër duhet të paraqesin kartën e identitetit.
4. Drejtoria e Menaxhimit të Objekteve Sportive dhe Shërbimeve afishon pranë palestrave orarin e përdorimit të palestës dhe ndërvepron me studentët për të plotësuar kërkesën, mban lidhje me laborantët e ngarkuar në palestër për të mundësuar një veprimtari normale të studentëve në palestër në përputhje me këtë vendim.
5. Rektorati, Dekanët e Fakulteteve, Drejtoria e Menaxhimit të Objekteve Sportive dhe Shërbimeve ndërmarin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Prof. Dr. Agron CUKA

REKTOR



Tiranë, më.....

KËRKESE

Lënda: Kërkesë për përdorimin e palestrës së UST.

Drejtuar: Dekanit të FSHL.

Prof. Dr. Bardhyl Misja

Unë përfaqësuesi i studentëve të listës së mëposhtme të vitit të Fakultetit.....

kërkoj përdorimin e palestrës, në ditën

Kërkojmë përdorimin e palestrës për arsye rekreative jashtë orëve të procesit mësimor.

Emër mbiemër i përfaqësuesit të studentëve

.....

Lista e studentëve është si më poshtë:

Tiranë, më.....

KËRKESË

Lënda: Kërkesë për përdorimin e palestrës së UST.

Drejtuar: Dekanit të FVFR.

Prof. Asc. Dr. Ferdinand Mara

Unë përfaqësuesi i studentëve të listës së mëposhtëme të vitit të Fakultetit.....

kërkoj përdorimin e palestrës, në ditën

Kërkojmë përdorimin e palestrës për arsye rekreative jashtë orëve të procesit mësimor.

Emër mbiemër i përfaqësuesit të studentëve

.....

Lista e studentëve është si më poshtë:

Tiranë, më.....